



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 238/ Prot.
6

Durrës, më 9 . 2 .2022

VENDIM

Nr 10 , datë 9 . 2 .2022

**"PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**

2022 - 2024


Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 09.02.2022.

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës 2022 – 2024.
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen :
 - Zv.Rektorët,
 - Dekanët e Fakulteteve,
 - Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

STRATEGJI NDËRKOMBËTARIZIMI

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAM D)
2022-2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Përmbajtja	
1. Baza ligjore	3
2. Qëllimi i Strategjisë	3
3. Ndërkombëtarizimi në UAMD	4
3.1 Koncepti i Ndërkombëtarizimit	4
3.2 Çfarë është ndërkombëtarizimi në arsimin e lartë?	5
3.3 Përse ndërkombëtarizim?	5
4. Ndërkombëtarizimi 2022-2024	6
5. Objektiva strategjike 2022-2024:	7
5.1	7
Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit, përmes organizimit dhe ofrimit të diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta me universitetet partnere	7
5.2	8
Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar	8
5.3	9
Rritja e numrit dhe cilësisë së zbatimit të projekteve në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit, transferimit të teknologjive dhe ato zhvillimore	9
5.4	9
Zhvillimi dhe forcimi i strukturave primare dhe atyre mbështetëse, për ndërkombëtarizimin e institucionit	9
5.5	10
Rritja e vizibilitetit të universitetit përmes rrjetëzimit në rrjetet universitare në rajonin e Ballkanit perëndimor, rajonit të mesdheut dhe vendeve anëtare të OSCE-së.	10
6. Burimet financiare në mbështetje të strategjisë	10
7. Objektivat sipas treguesve të matshëm dhe mjeteve	11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

1. Baza ligjore

Kjo strategji mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Statutin (miratuar me urdhër Nr.385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë) dhe Rregulloren (miratuar me Vendim nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik) e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD);
- Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 5, datë 17.01.2020) si edhe Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- Rregulloren Financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Neni 43;

të cilat janë baza kryesore juridike dhe operationale e kësaj strategjie.

2. Qëllimi i Strategjisë

Kjo startegji, synon të përcaktojë objektivat e përgjithshëm institucional në lidhje me dimensionin e ndërkombëtarizimit në institucionin e arsimit të lartë. Ajo përcakton qartë treguesit e matshëm përkrah çdo objektiv strategjik, sëbashku me mjetet e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave.

Ajo kontribuon kundrejt:

- (i) vizionit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, i cili si institucion, synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë;
- (ii) misionit të tij për nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeri-tjetrit, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin në tërësi;
- (iii) Planit të Zhvillimit Strategjik 2020-2025 (objektivi nr. 3) duke i ofruar studentëve dije dhe njohuri akademike cilësore, në përputhje me standardet ndërkombëtare për arsimin e lartë, përmes pjesëmarrjes aktive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, shkëmbimeve me institucione homologe në vendet e BE-së, si dhe nxitjen e partneriteteve, duke promovuar universitetin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

3. Ndërkombëtarizimi në UAMD

UAMD ka vendosur si një ndër prioritetet strategjike ndërkombëtarizimin. Ka treguar të jetë lider në aspekte të ndërkombëtarizimit (*shih Shtojca 1- Arritjet e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2019-2021*) dhe kërkon të jetë një aktor i rëndësishëm në arritjen e standarteve ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Ky universitet, kërkon të jetë qendër e rëndësishme e bashkëpunimit universitar, kërkimit shkencor, aktivitetit akademik dhe promovimit të vlerave zhvilluese të arsimit të lartë, për një arsim cilësor dhe kontribut të rëndësishëm në shoqëri. Ndaj, si institucion, i nevojitet që të veprojë me efikasitet, shpejtësi dhe fleksibilitet ndaj një shoqërie gjithnjë e në ndryshim.

Përpos arritjeve të deritanishme, ka ende punë për të bërë në drejtim të ndërkombëtarizimit të institucionit, specifikisht, në përafrimin e programeve të përbashkëta të studimit dhe diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta. Paracaktimi i ndërkombëtarizimit si objektiv strategjik në planin afatmesëm të zhvillimit të institucionit (2020-2024), të ndjekjes së një strategjie të mirëfilltë të ndërkombëtarizimit me një qasje të integruar në institucion dhe matja e vazhdueshme e progresit të institucionit në këtë drejtim, janë tregues të rëndësishëm të peshës që zë ndërkombëtarizimi.

Duke kërkuar përfitim të ndërsjellë për universitetin, komunitetin dhe palët e interesuara, UAMD dëshiron të arrijë një pozicion parësor në fushën e kërkimit, inovacionit dhe transferimit të teknologjive.

3.1 Koncepti i Ndërkombëtarizimit

Ndërkombëtarizimi, përgjatë çerek shekullit të fundit, ka filluar të marrë trajtë duke u shndërruar në një komponent global, strategjik dhe faktor të rëndësishëm në arsimin e lartë. Nësë kohe më parë (*rreth viteve 60*) fokusi i ndërkombëtarizimit lidhej me aspekte të bursave për studentë të huaj apo projekte ndërkombëtare, sot elementet e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë formëzohen në elementë të programeve të përbashkëta/të dyfishta të studimit, mobilitete studentësh dhe stafi, qytetari globale, rankim ndërkombëtar institucioni, branding dhe elementë të tjerë si këto.

Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë, kërkon që institucionet të përshtasin dhe përcaktojnë linja veprime në funksion të ndërkombëtarizimit. Institucionet të cilat kanë integruar me kohë këtë dimension *sifsh. elementin e rishikimit dhe përshtatjes së kurrikulave mes universitetesh partnere*, tregojnë më së miri përfitimet praktike të ndërkombëtarizimit, duke diplomuar studentë të aftë dhe me kompetenca për t'u përballur si në nivel lokal po ashtu edhe global.

Ndërkombëtarizimi është përfshirë në strategji institucionale dhe/apo plane veprimi si në nivel kombëtar po ashtu edhe në plane dhe agjenda ndërkombëtare. Arsytet e përfshirjes mund të jenë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

të shumta, por, në parim, duket sikur elementi i ndërkombëtarizimit në arsimin e lartë, vjen si përgjigje ndaj globalizmit, rritjes së vazhdueshme të konkureshmërisë midis institucioneve të arsimit të lartë dhe si kundërpërgjigje ndaj nevojës që studentët të jenë të përgatitur, për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve të shpejta si në jetën personale dhe profesionale, po ashtu edhe në komunitetin lokal dhe atë global.

3.2 Çfarë është ndërkombëtarizimi në arsimin e lartë?

Koncepti i ndërkombëtarizimit në arsimin e lartë (*edhe pse jo i ri si term*), shpesh nënkupton gjëra të ndryshme për individë të ndryshëm. Ky koncept duket sikur përfshin gjithçka që lidhet me aspektet globale, ndërkulturore apo ndërkombëtare. Në kuadër të spektrit të gjërë të kuptimeve dhe interpretimeve, për disa mund të nënkuptojë një seri aktivitesh ndërkombëtare, siç mund të jenë

- mobilitete të studentëve apo të stafit;
- rrjetëzim dhe antarësim në rrjete ndërkombëtare;
- partneritete dhe projekte; programe të reja akademike të përbashkëta dhe/apo të dyfishta;
- iniciativa të përbashkëta (*mes institucioneve partnere*) të kërkimit shkencor.

Për disa të tjerë mund të nënkuptojë ofrimin e programeve të studimit përmes disa proceseve dhe platformave bazuar në zhvillimin e teknologjisë, të cilat janë risi krahasimisht me metodën tradicionale të procesit të mësimdhënies-mësimnxënies apo përfshirjen e dimensionit global dhe ndërkulturore në kurrikula.

Të tjerë mund t'a shohin ndërkombëtarizimin nën perspektivën e rakimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, apo për të rekrutuar studentët më të mirë dhe ofruar bursat më të mira. Projektet ndërkombëtare, janë konsideruar gjithashtu, si pjesë e ndërkombëtarizimit. Shpesh, ky interpretim i gjerë, mund të bëjë që termi në vetvete të humbasë fokusin.

Termi i përdorur si ndërkombëtarizim në arsimin e lartë, dakortësuar dhe referuar masivisht është "*ndërkombëtarizimi është procesi i integrit të dimensioneve ndërkombëtare, ndërkulturore dhe globale në qëllimet strategjike dhe funksionet primare të arsimit të lartë, në nivel institucional dhe atë kombëtar*" (Knight 2004).

3.3 Përse ndërkombëtarizim?

Institucionet e arsimit të lartë, si krijues dhe shpërndarës të dijeve dhe njohurive, si edukues të brezave të ardhshëm, janë të detyruar të përballen me problematikat kyçe të kohës. Ndërkombëtarizimi, është pikërisht një nga dimensionet që mundëson këto institucione, t'u përgjigjen sfidave dhe njëkohësisht mundësive me të cilat përballen shoqëritë sot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Ka shumë arsye dhe stimuj që mund të shtyjnë nivelin drejtues të institucioneve të arsimit të lartë, të përfshijnë ndërkombëtarizimin si pjesë thelbësore dhe ndër objektivat strategjike të institucionit. Ndër to mund të përmendim disa, si psh. rritja e ndërgjegjësimit se kompetencat ndërkulturore të kërkuara në kontekstin global janë mjaft të rëndësishme dhe të nevojshme për t'u përballur, për të punuar e jetuar në shoqëritë multikulturore.

Nga ana tjetër, rritja e kërkesës nga ana e punëdhënësve për forcë pune të kualifikuar dhe me kompetenca, si edhe kërkesa për formim nga ana e studentëve, reflekton interesin në rritje ndaj ndërkombëtarizimit i cili mundëson përfitimin e po këtyre kompetencave dhe eksperiencave ndërkulturore që nevojitet të përfitohen përgjatë arsimit të lartë, duke e listuar kështu ndërkombëtarizimin, si një forcë shtytëse për ndryshim.

Diplomat e përbashkëta dhe/apo të shumëfishta me institucione partnere krijojnë më shumë hapësira për punësim. Rrjetëzimet dhe antarësimet në rrjete partneritësh, në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal zgjerojnë mundësitë e bashkëpunimit, i konsolidojnë marrëdhëniet dhe vitalizojnë institucionet duke i bërë ata më të konkureshëm dhe më cilësorë.

Kërkesa për të tërhequr dhe promovuar talente, nevojitet që të shoqërohen edhe me çmime për patentime si edhe transferim njohurish. Vitet e fundit, kërkimi shkencor është bërë më kompleks, duke kërkuar gjithnjë e më rritje bashkëpunim mes institucioneve dhe akademikësh, duke u rritur kështu edhe në konkureshmëri. Planifikimi dhe realizimi i një infrastrukture kërkimore-shkencore, rritja e kapaciteteve për kërkim shkencor, zhvillimi i platformave të reja për mësimdhënie dhe koordinim më i mirë i të gjitha instancave, kërkojnë një fokus më strategjik mbi zhvillimet e kapaciteteve dhe sistemet apo politikat ndërkombëtare të kërkimit shkencor. Nevoja për të qënë fleksibël, për të mundësuar infrastrukturë alternativë ndaj mësimdhënies tradicionale dhe kërkimit, u evidentua qartësisht edhe nga situata pandemike e cila vuri në sfidë të gjithë sistemin arsimor, jo vetëm atë të lartë.

Mes këtyre mundësive dhe sfidave në rang global, arsimit të lartë i nevojitet gjithashtu, të ndërlihet aktivisht edhe me realitetin lokal, për të mundësuar që të dy dimensionet, pra ai lokal dhe global, të vijnë sëbashku në harmoni duke ushqyer njeri-tjetrin.

4. Ndërkombëtarizimi 2022-2024

Ndërkombëtarizimi konsiderohet si një proces i dyfishtë institucional, së brendshmi dhe së jashtmi.

Së brendshmi, kërkon mbështetje institucionale, dëshirë, përkushtim dhe vullnet nga ana e palëve, për t'u përballur me mundësitë dhe sfidat. Konkretisht:

- Rishikim dhe përshtatje të kurrikulave; mësimdhënie në gjuhë të huaj;
- Arsimim të hapur për të gjithë - fleksibilitet në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies (i kuptuar ky i fundit si një proces i ndryshimit ndaj procesit tradicional të mësimdhënies)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISTU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

dhe integrimin e metodave të reja të mësimdhënies siç mund të jenë: mësimi në distancë, peer to peer learning etj).;

- *Mundësi akomodimi të studentëve dhe stafit të huaj duke ofruar facilitetet përkatëse;*
- *Aktivitete kërkimore-shkencore apo të një natyre tjetër, të përbashkëta dhe ekstra-kurrikulare.*

Dimensioni ndërkombëtar i kurrikulës, nevojitet që të përparojë si në aspekte të lëndëve po ashtu edhe të gjuhës së huaj të studiuar, për t'a integruar dimensionin ndërkombëtar po ashtu edhe në përmbajtje. Gjithashtu, nevojitet t'i vihet theksi edhe rezultateve të studentëve, duke gjetur mjete për të evidentuar dhe ndarë si praktika të mira eksperiencat dhe kompetencat e tyre ndërkombëtare dhe ndërkulturore.

Së jashtmi, kërkon gjithashtu përkushtim dhe seriozitet në marrëdhënie dhe besueshmëri në partneritete:

- *Mobilitet studentësh/stafi;*
- *Projekte kërkimore shkencore dhe aktivitete të përbashkëta;*
- *Projekte zhvillimore;*
- *Partneritete dhe rrjetëzime.*

Mobiliteti (fizik) akademik i personave (staf dhe studentë) nevojitet të shoqërohet paralelisht me mobilitete programesh studimi (binjakëzime/diplomat përbashkëta/të dyfishta) dhe ofrim të kampuseve dhe Hub-eve të edukimit.

Edukimi ndërkufitar (*mes vendeve me afërsi gjeografike*), po shndërrohet gradualisht nga modele bashkëpunimi kuadër, në modele partneriteti dhe më së fundi në modele të konkurueshmërisë. Nuk ka dyshim, që ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, gjithashtu edhe me kompleks i bashkëshoqëruar me sfida.

Komponent i rëndësishëm që shoqëron të gjithë procesin e ndërkombëtarizimit është cilësia (si ajo e kurrikulës, proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, praktikat, apo shërbimet mbështetëse) dhe monitorimi i vazhdueshëm i punës.

5. Objektiva strategjike 2022-2024:

5.1

Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit, përmes organizimit dhe ofrimit të diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta me universitetet partnere



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- nënshkrimit të programeve të përbashkëta/dyfishta;
- programeve që mbështesin shkëmbimet e stafit akademik dhe administrativ;
- programeve që mbështesin shkëmbimin e studentëve të cikleve të ndryshme të studimit për periudha semestrale studimi (ose më të gjata) ose për periudha të praktikave mësimore;
- aktiviteteve dhe publikime të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor dhe/apo inovacionit;
- konferencave, seminareve, takimeve akademike, eventeve, shkollave verore etj.. që nxisin rritjen e kapaciteteve si edhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- rritjes së numrit të programeve të përbashkëta dhe/apo të dyfishta në gjuhën angleze apo tjetër;
- rritjes së numrit të studentëve të huaj që studiojnë në këtë universitet;
- ofrimit të programeve të studimit në gjuhën angleze.

5.2

Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar

UAMD është përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit dhe nxitjen e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar. Kjo strategji mbështet në tërësi zhvillimin e partneriteteve publik-privat, me komunitetin e biznesit, think tank-eve, shoqërisë civile dhe komunitetin. Një numër i konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Strategjia e ndërkombëtarizimit mbështet rivitalizimin, në nivel vertikal dhe horizontal, të marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit, si edhe nënshkrim të marrëveshjeve të reja me universitete brenda dhe jashtë vendit, kryesisht ato perëndimore, me grupet e interesit për të formalizuar apo institucionalizuar marrëdhënien, për të patur një ambjent favorizues dhe stimulues për kërkimin shkencor dhe për të realizuar shkëmbime të stafit akademik dhe të studentëve. UAMD synon gjithashtu, nënshkrimin e marrëveshjeve të reja dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar, zbatimin e tyre në praktikë, monitorimin e ecurisë së tyre, vlerësimin/matjen e progresit të arritur dhe impaktit potencial me mundësi përshkallëzimi të praktikave të mira në nivel kombëtar dhe më gjerë.

Në nivel lokal dhe kombëtar marrëveshjet do të mund të operacionalizohen duke i monitoruar me kujdes, duke i vlerësuar dhe përshkallëzuar praktikatat e mira. Në nivelin lokal është kyç partneriteti me grupet e interesit për eksplorimin e mundësive për aplikime të përbashkëta në kuadër të programeve të financuara nga BE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Në nivel ballkanik synohet ndërtimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me universitetet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, për të zgjeruar mundësinë e aplikimeve ndërkufitare dhe transnacionale, përfitimt të ndërsjellë në kuadër të procesit të aderimit në Bashkimin Europian; aplikim në nivel rajonal të projekteve zhvillimore të rajonit të Ballkanit Perëndimor nën programe si IPA CBC/ INTERREG, IPARD, Norwegian Aid etj., për të rritur influencën dhe zgjeruar partneritetin në nivel ballkanik.

Në nivel ndërkombëtar:

- rrjetëzimi me vende anëtare të OSCE-së, zgjerimi i marrëveshjeve me universitete dhe agjenci kërkimore të huaja me qëllim transferimin e dijeve dhe praktikave të mira;
- eksplorimi i teknikave inovative në mësimdhënie, mësimnxënie dhe transferim dijeshe dhe praktikash pozitive;
- shkëmbimi i stafit akademik dhe studentor për periudha të caktuara; bashkëpunimet në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve zhvillimore;
- eksplorimi i mundësisë së akomodimit të stafit të huaj për periudha internship dhe shkëmbimi eksperience apo rritje kapacitetesh të ndërsjella.

5.3

Rritja e numrit dhe cilësisë së zbatimit të projekteve në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit, transferimit të teknologjive dhe ato zhvillimore

UAMD është i angazhuar intensivisht në aplikimin dhe zbatimin e projekteve që lidhen me rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit për arsimin e lartë, projekte që targetojnë zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve pranë universiteteve të huaja, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, në bashkëpunim me stafin lokal, si dhe pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratorëve.

5.4

Zhvillimi dhe forcimi i strukturave primare dhe atyre mbështetëse, për ndërkombëtarizimin e institucionit

Drejtorja e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, si një njësi e integruar në strukturat e universitetit, kontribuon në lehtësimin e procesit të hartimit dhe zbatimit të projekteve me partnerë dhe donatorë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Fokusi i punës së kësaj Drejtorie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

orientohet kryesisht drejt programeve të Bashkimit Europian për Kërkim dhe Zhvillim si: Erasmus+, Horizon Europe; European Programme for Science and Technology (COST) etj., si dhe shtrirjes së rrjetëzimit dhe ndërtimit të partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë do të jetë i mundur përmes rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të Drejtorisë për t'u përballur me nevojat dhe risitë në fushën e aplikimeve për projekte si edhe atë të monitorimit të tyre, bazuar në udhëzimet dhe rregullat e donatorëve.

Ofrimi i mundësisë për rritje kapaciteti të stafit akademik mundësohet nga hartëzimi i nevojave dhe i mundësive që ofrojnë institucionet apo agjencitë donatore për rritje kapacitetesh, brenda dhe jashtë vendit, apo sipas modaliteteve në platformat online.

5.5

Rritja e vizibilitetit të universitetit përmes rrjetëzimit në rrjetet universitare në rajonin e Ballkanit Perëndimor, rajonit të mesdheut dhe vendeve anëtare të OSCE-së

UAMD synon të jetë i pranishëm aktivisht në aktivitete ndërkombëtare shkencore dhe botuese. Aktivitetet ndërkombëtare do të kontribuojnë në njohjen dhe rankimin ndërkombëtar të universitetit dhe jo vetëm. Si rezultat i kontakteve të krijuara nga lëvizjet e studentëve e akademikëve dhe nga krahasimi i kurrikulave, i cili është i nevojshëm në rastin e shkëmbimit të studentëve, stafet akademike do të reflektojnë lidhur me edukimin që ofrohet në UAMD. Këto aktivitete do të kontribuojnë në cilësinë e edukimit dhe të trajnimit si edhe në përshtatjen dhe përhapjen e "praktikave të mira".

Më gjërë, komuniteti do të përfitojë nga ndërkombëtarizimi i universitetit duke forcuar bashkëpunimin me biznesin dhe aktorë të tjerë në shoqëri, si dhe zgjerimin e kontakteve që janë të rëndësishëm për interesat ekonomike, politike dhe kulturore të komunitetit.

6. Burimet financiare në mbështetje të strategjisë

Burimet financiare mbi të cilat mbështetet aktiviteti i zbatimit të kësaj strategjie janë të parashikuara në ligj (shih seksionin 1 më lart— Baza Ligjore). Çdo vit, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, depoziton pranë Drejtorisë Financiare në institucion planin e kërkesës buxhetore për vitin pasardhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

7. Objektivat sipas treguesve të matshëm dhe mjeteve

Objektivi	Treguesi e matshëm	Mjete
1. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit, përmes organizimit dhe ofrimit të diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta me universitetet partnere	# nënshkrim i programeve të përbashkëta/dyfishta; # i programeve që mbështesin shkëmbimet e stafit akademik dhe administrativ; # i programeve që mbështesin shkëmbimin e studentëve të cikleve të ndryshme të studimit për periudha semestrale studimi (ose më të gjata) ose për periudha të praktikave mësimore; # i aktiviteteve dhe publikime të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor dhe /apo inovacionit; # i konferencave, seminareve, takimeve akademike, eventeve, shkollave verore etj. që rrisin rritjen e kapaciteteve si edhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies; # i programeve të përbashkëta dhe/apo të dyfishta në gjuhën angleze apo tjetër; # i studentëve të huaj që studiojnë në UAMD; # i programeve të studimit të ofruara në gjuhën angleze.	- Infrastrukturë e përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies cilësore; - Mjete financiare të disponueshme dhe në kohë, për realizim aktiviteteve dhe akses ndaj tyre; - Aftësi të stafit akademik për mësimdhënies në gjuhën angleze; - Infrastrukturë të përshtatshme në mësimdhënie dhe akomodim për studentët dhe stafin e huaj; - Konsorciume dhe mundësi për shfrytëzim të literaturës së huaj fizike dhe online.
2. Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, dhe ndërkombëtar	# i marrëveshjeve dy palëshe; # i marrëveshjeve shumëpalëshe; # i marrëveshjeve në nivel kombëtar; # i marrëveshjeve në nivel rajonal;	- Disponueshmëri institucionale; - Mekanizma të ngritur që rregullojnë marrëdhënien dhe lehtësojnë zbatimin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

	# i marrëveshjeve në nivel ndërkombëtar; # dhe tipologjia e marrëveshjeve sipas entiteteve.	Disponueshmëri e stafit për të ndërtuar marrëdhënie me palë të treta; Infrastrukturë e nevojshme për zbatimin e marrëveshjeve (si ato të burimeve njerëzore po ashtu dhe ato financiare e infrastrukturë fizike); Vullnet për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies përmes bashkëpunimit akademik.
3. Rritja e numrit dhe cilësisë së zbatimit të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive;	# i projekteve të aplikuara si lider dhe/apo si partner; # i projekteve të fituara si lider dhe/apo si partner; Rritje e tipologjisë së programeve të projekteve të aplikuara; Rritje e tipologjisë së programeve të projekteve të fituara; % e numrit të projekteve të fituara në raport me projektet e aplikuara; # i projekteve të zbatuara me sukses; # të mësimave përmes praktikave të mira dhe mësimave të nxjerra nga zbatimi; # i shkëmbimeve të stafëve dhe studenteve përmes zbatimit të projekteve; # i konsorciumeve të ngritura për aplikim; Rritje kapacitetesh për stafin përmes zbatimit të projekteve.	Ngritje e grupeve të punës për projekte pranë çdo fakulteti; Burime njerëzore të mjaftueshme dhe me kapacitetet përkatëse për të mundësuar aplikimet; Rritje kapacitetesh për projekte të caktuara me natyrë kërkimore shkencore; Mjete financiare në dispozicion për të bashkë-financuar; Disponueshmëri të partnerëve të huaj për konsorcium.
4. Zhvillimi dhe forcimi i strukturave primare dhe atyre mbështetëse, për ndërkombëtarizimin e institucionit	Kapacitete të rritura dhe të përshtatshme për aplikim dhe zbatim; Monitorim dhe realizim me sukses të	Mundësi për trajnime dhe rritje kapacitetesh; Disponueshmëri financiare për aktivitete;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

	<i>projekteve;</i> <i>Mbështetje në realizimin e</i> <i>aktiviteteve të përbashkëta me</i> <i>partnerë;</i> <i>Realizim i sesioneve informuese për</i> <i>shkëmbimet Erasmus+ për studentët;</i> <i>Pjesëmarrje dhe realizimi i</i> <i>panaireve;</i> <i>Rritje e numrit të shkëmbimeve të</i> <i>studentëve dhe të stafit të UAMD në</i> <i>universitetet europiane;</i>	<i>Mësime dhe eksperiencë të</i> <i>ndara me homologë;</i> <i>Orientime dhe udhëzime të</i> <i>ndjekura rigorozisht për</i> <i>aplikimet dhe zbatimet e</i> <i>projekteve.</i>
<i>5. Rritja e vizibilitetit të</i> <i>universitetit, përmes</i> <i>rrjetëzimit në rrjetet</i> <i>universitare në rajonin e</i> <i>Ballkanit perëndimor,</i> <i>rajonit të mesdheut dhe</i> <i>vendeve anëtare të</i> <i>OSCE-së.</i>	<i># i antarësimeve në rrjete</i> <i>ndërkombëtare;</i> <i># i aktiviteteve të përbashkëta (si</i> <i>psh. Konferenca, shkolla verore</i> <i>etj.);</i> <i>Rritje e vizibilitetit të UAMD në</i> <i>arenën ndërkombëtare të arsimit të</i> <i>lartë.</i>	<i>Disponueshmëri financiare</i> <i>për të paguar kuotat e</i> <i>antarësimit.</i>